



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 16.8.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Tefik Mehmeti, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Mustafë Krasniqi.

Në mbledhje morën pjesë edhe Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore dhe drejtorët e drejtorive të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues.

Filloi diskutimi rreth rendit të ditës.

Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, propozoi që pika e katërt, "*Propozimvendimi për shqyrtimin publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Lakërishta"*", të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin që materiali të përpunohet edhe më tej.

Me propozimin që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës, njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë;
2. Propozimvendimi për miratimin e Planit zhvillimor të komunës për periudhën 2013- 2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës për periudhën 2013-2016;
4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane";
5. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
6. Propozimvendimi përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë;
7. Propozimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik/juridik;
8. Propozimvendimi për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet;

9. Propozimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2014;
10. Propozimvendimi për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, Prishtinë;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëseri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit zhvillimor të komunës për periudhën 2013 - 2022, Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, tha se ky është një dokument i miratuar si projekt. Për këtë është mbajtur debati publik, ku janë dhënë vërejtje dhe sugjerime. Për shqyrtimin e këtyre vërejtjeve është formuar një grup punues, ku disa nga vërejtjet dhe sugjerimet janë marrë si të arsyeshme dhe janë inkorporuar në tekstin final.

Tefik Mehmeti për këtë plan bëri disa vërejtje, konkretisht rreth emërimit të titujve, duke cekur se titujt e disa institucioneve, siç është bibliotekat etj., duhet të shënohen saktë. Vërejtje bëri edhe rreth emërimit të unazave dhe propozoi që emërtimet e tyre të jenë të sakta. Në këtë material janë lëshuar edhe disa gabime të tjera që duhet të evitohen.

Kryesuesi tha se kemi qenë të angazhuar rreth përpunimit të këtij materiali dhe disa vërejtje të cilat i ka shqyrtuar komisioni, janë inkorporuar në tekst.

U konstatua se njëseri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit zhvillimor të komunës për periudhën 2013- 2022 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës për periudhën 2013-2016, Agim Dibrani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, tha se duhet të jetë një harmonizim rreth titullimit të këtij dokumenti, a të jetë zhvillim lokal ekonomik, apo zhvillim ekonomik lokal. Vërejtje bëri edhe në nenin 4 të Propozimvendimit, duke propozuar që harta e komunës së Prishtinës t'i bashkëngjitet këtij vendimi ose jo.

Tefik Mehmeti vërejtje bëri për numrin rendor 177, ku propozoi që të jetë: ... Ndërtimi i shkollës fillore në Mat I (në mes shkollës fillore "Ismail Qemali" dhe shkollës fillore "Iliria").

Shemsi Veseli fillimisht tha se e përgëzoi punën e grupit punues që ka hartuar këtë strategji, megjithatë ka vend për vërejtje dhe plotësime, të cilat do ta pasuronin këtë material. Nga vërejtjet e paraqitura ishin: në faqen 5, rreth mekanizmave, e që në fakt nuk janë të detajuar se cilët janë ata mekanizma, nuk përcaktohet forma se si do të

arrihen ato synime që janë paraparë, pastaj në faqen 6, të definohet saktë se çka është dashtë të thuhet aty: *“Ky rregullim institucional nuk mund të konsiderohet i kompletuar dhe funksional pa miratimin e Ligjit për Prishtinën”*. Vërejtje bëri edhe te tabelat buxhetore, ku është dashtë që të jetë një lloj proporcioni me të hyrat vetanake, sidomos të hyrat nga lejet e ndërtimit. Do të duhej të jepeshin të dhëna rreth operimit të bizneseve, për zhvillimin rural, do të duhej bërë një analizë më e detajuar për gjendjen dhe rrethanat urbane. Edhe në fushën e infrastrukturës lokale nuk jepen shumë të dhëna. Ai propozoi që këto vërejtje dhe plotësime të merren parasysht, të inkorporohen në tekst dhe Propozimvendimin nuk e votoi.

Me një votë kundër, u konstatua se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës për periudhën 2013-2016, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Për Propozimvendimin për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes “Tophane”, Behxhet Musliu tha se ky plan rregullues është miratuar në Kuvend në vitin 2005, në një zonë të ndërtuar, por nuk ka mundur të realizohet për shkak të disa pengesave, andaj dhe është propozuar që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i tij.

Aziz Pacolli kërkoi që pas miratimit të këtij propozimvendimi, edhe të zbatohet.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes “Tophane” dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013, Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, tha se me këtë propozimvendim bëhet një ndryshim i vogël *për projektin e rrugës “Ndue Përlleshi”*, mjetet kthehen prapë për këtë projekt dhe për *Pajisjet me kabinete, inventar shkollor dhe libra për biblioteka shkollore*, mjete të cilat duhet të kthehen dhe nuk janë pjesë e rishikimit.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, tha se Kryetari i Komunës me zyrtarë të Komunës, është takuar me përfaqësuesit e Ipeshkëvisë së Kosovës dhe nga takimi është rekomanduar që organet përgjegjëse të Komunës ta bëjnë piketimin e lokacionit të sakët të objektit të katedrales.

Kryesuesi tha se ne iu kemi referuar oborrit të shkollës dhe nga ana e tyre është një mosrespektim, se aty ku ata pretendojnë se duhet të jetë në kuadër të katedrales, është rruga dhe trotuari, andaj kërkoj që të bëhet edhe një herë një matje e sakët e parcelës. **Aziz Pacolli** kërkoj që të përkufizohet vija e sakët e lokacionit, posaçërisht në pjesën ku kanë qenë të vendosura lokalet afariste.

Me propozimet e dhëna, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimin për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik/juridik, në pika të shkurtra të pranishmit i njoftoi Agim Salihu.

Shemsi Vesli ngriti një shqetësim rreth këtij propozimi, duke shtuar se ka edhe raste të tjera që duhet vepruar kështu, pra të propozohen edhe emra të tjerë. Këtë propozim nuk do ta votoj, për shkak se po përdoren standarde të dyfishta.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Veseli, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Me një votë kundër, u konstatua se u përkrah Propozimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik/juridik dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Për Propozimvendimin për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet, arsyetimin për pezullimin e procedurës e paraqiti Agim Salihu.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë

Lidhur me Propozimin për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2014, në pika të shkurtra informoi Agim Salihu.

Aziz Pacolli kërkoj që të jetë një sqarim më i detajuar rreth kamatave, pasi që çështja e tyre është tejet problematike.

Kryesuesi tha se këtë mbikëqyrje e bënë ministria përkatëse.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2014, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e dhjetë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, Prishtinë, Xhelil Bektashi tha se e pasqyruam këtë rishikim të mjeteve, dhe kjo është bërë brenda limiteve buxhetore. Këto mjete do të destinohen për mbjellje të drurëve.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Të ndryshme

Shemsi Veseli paraqiti shqetësimin e qytetarit Xhemajl Veseli, për mos përfshirjen e tij në listën e përfituesve të banesave për rastet me përkujdesje sociale, duke shtuar se personi në fjalë ka nge padi ndaj anëtarëve të komisionit për ndarjen e banesave.

Mbledhja mbaroi në orën 16:20.

Procesmbajtësi

Zijadin Gashi

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc.i dipl.